

STATUT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ITS-Italian Projection & Solutions” SHPK

Kreu I

Forma, Emri, Objekti, Afati, Selia

Neni 1

“ITS-Italian Projection & Solutions” SHPK (“Shoqëria”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, kapitali i të cilit zotërohet nga ortakët e tij si në vijim:

- i.* **Z. Bledar Kulla**, shtetas shqiptar, i biri i Janit, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, më 08.03.1982, me letërnjoftim me nr. personal I20308085R, ortak zotërues i një kuote që përfaqëson 50 % (*pesëdhjetë*) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- ii.* **Z. Thierry Jean Pierre Di Garbo**, shtetas italian, i biri i Giovanni, lindur në Milano, më 26.05.1973, banues ne Rome, Itali, me letërnjoftim italian nr. AY5554901, ortak zotërues i një kuote që përfaqëson 50 % (*pesëdhjetë*) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 2

Emri i Shoqërisë është “ITS-Italian Projection & Solutions” SHPK. Shoqëria ka vulën e saj. Emri i Shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 3

Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 të këtij statuti është krijuar me mjetet e vetë themeluesve. Afati i Shoqërisë është për një afat të pakufizuar.

Neni 4

Shoqëria është e themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar (“Ligji për shoqëritë tregtare”). Marrëdhëniet ligjore mes ortakëve dhe punëmarrësve si dhe marrëdhëniet ligjore me palët e treta, si dhe organizimi dhe operimi i shoqërisë rregullohen nga ky Statut, Ligji për shoqëritë tregtare dhe nga ligjet në fuqi.

Neni 5

Nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar të shoqërive (Q.K.B.), Shoqëria përfiton personalitet juridik dhe fiton statusin e personit juridik të të drejtës shqiptare. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në zbatim të ligjeve shqiptare si dhe dispozitave të tjera të parashikuara në këtë Statut.

Neni 6

Selia e Shoqërisë është në Tiranë (Shqipëri), Rruga "Myslym Shyri", Sh. Berxolli, P. 117/1, pjese ap.kat perdhe/magazine, zona kadastrale 8380. Selia mund të zhvendoset në çfarëdo adresë tjetër



me vendim të thjeshtë të organit administrativ (administratorit), që ka të drejtë të bëj më pas regjistrimet përkatëse në regjistrin tregtar.

Administratori/ët mund të regjistrojë **kudo**, qoftë në Shqipëri apo jashtë vendit, njësi sekondare, filiale, degë, agjensi apo zyra përfaqësimi.

Neni 7

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve si më poshtë:

Blerje shitje, ndertim, shkatarrim dhe ristrukturim i ndertesave civile , industriale dhe ndertesave të çfaredo lloj natyre, duke përfshirë toka dhe toka rustike; Punime ndertimi të çdo natyre si levizja e dherave dhe asfaltimin e rrugëve pa asfalt. Instalim, riparim, menaxhim, mirëmbajtje, realizim dhe shitje me pakicë dhe shumicë dhe furnizim në territorin kombëtar dhe ndërkombëtar të impianteve elektrike, civile dhe industriale, të brendshme dhe të jashtme, të impianteve telefonike, radiofoni, videocitofoni, televizione satelitare dhe toksore, të rrjeteve internet lan. Impiante termike, ventilacion dhe kondicionimi. Impiante të ngritjes të peshave, ashensore, shkalle levizëse dhe transportimi në përgjithësi. Impiante transport gaz. Sisteme kontrolli. Impiante të centraleve elektrike, të kabinave të transformacionit të tensionit mesëm dhe të ulët, aparateve të ndryshme. Impiante të jashtme të ndricimit, linjave telefonike dhe pune të lidhura me këto. Impiante rrufe pritëse, impiante alarmi, kundër zjarrit dhe telekamera. Impiante të telekomunikimit të çdo lloji. Impiante "green energy".

Sherbime pastrimi të çdo natyre private dhe industriale;

Furnizim, riparim, shitje me pakicë dhe shumicë, përfaqësim dhe montim të pjesëkombimit të aksesorëve dhe materialeve të objektit të firmës, si dhe artikuj, materiale dhe aksesor informatik, elektrik dhe elektronik, përfshirë dhe prodhimin, furnizimin dhe administrim të software-ve

Administrim të shërbimeve komerciale për shitjen e materialeve të ndërtimit, duke përfshirë aksesor për ndërtimin, qeramik, hidrosanitar, arredim e të tjera, si dhe laborator për aktivitetin e me sipërm.

Ndërtimin e pallateve civile, industriale, monumentale, të kompletuara me impiantet përkatëse.

Punë murature të lidhura me komplekse për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Shoqëria mund të ndërtojë dhe/ose të furnizojë, të vejë në punë dhe riparojë pjesë elektrike dhe elektronike, mund të hapë dhe xhestojë qendër asistence (laborator), dyqan dhe magazin për shitjen dhe furnizimin e materialeve elektrike dhe elektronike në përgjithësi, aksesor dhe pjesëkombimi, si dhe produkte të ngjashme për konton e vet dhe për të tretë.

Për përmbushjen e qëllimit, shoqëria mund të mbështetet në shoqëri të tjera dhe, po të jetë e kërkuar nga ligjet në fuqi dhe në të ardhmen, të bashkëpunojë me profesionistë e teknikë të regjistruar në kuadrin e fushës së tij.

Shoqëria, për zbatimin e objektit të saj, më përgjithësisht mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të domosdoshëm për përmbushjen e qëllimit të shoqërisë, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Përgjegjësia e ortakëve kufizohet në kontributet e nënshkuara.

Neni 9

Ortakët gëzojnë të drejtat e mëposhtme kryesore:

- marrin pjesë në fitimet e Shoqërisë në të gjitha format dhe sasi të, sipas këtij Statuti;
- marrin pjesë në asamblenë e ortakëve personalisht ose përmes një përfaqësuesi të tyre;
- kërkojnë dhe marrin të gjithë informacionin e lidhur me gjendjen tregtare të Shoqërisë, të tilla si të gjitha dokumentet e Shoqërisë, përfshirë por jo vetëm, bilancin, llogaritë financiare etj.;
- emërojnë dhe shkarkojnë administratorët, ekspertin kontabël dhe likuiduesit;
- mund të tërhiqen nga Shoqëria. Tërheqja e tyre nuk i çliron ortakët nga detyrimet financiare të mbetura ndaj Shoqërisë.

Kreu II

Kapitali i Shoqërisë

Neni 10

Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 1.000.000 (*nje milion*) Lekë, i nënshkuar në të holla nga Ortakët e shoqërisë që i korrespondon 100% (një qind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali përbëhet nga 2 (dy) kuota të nënshkuara dhe të shlyera plotësisht me vlerë totale prej me 1.000.000 (*nje milion*) Lekë, ndërmjet ortakëve si më poshtë:

- a. **Z. Bledar Kulla**, zotërues i 50 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë me një vlerë totale prej 500.000 (*pesëqind mijë*) Lek;
- b. **Z. Thierry Jean Pierre Di Garbo**, zotërues i 50 % të kapitalit të Shoqërisë, që përfaqëson 1 kuotë me një vlerë totale prej 500.000 (*pesëqind mijë*) Lek.

Neni 11

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet pa asnjë lloj kufizimi në çdo moment, në një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 12

Shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare. Në çdo rast kapitali i shoqërisë nuk mund të jetë më i vogël se minimumi i parashikuar nga ligji.

Neni 13

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme me akte mes të gjallëve apo me trashëgimi *mortis causa*, në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Neni 14

Shoqëria ka të drejtën të shesë apo disponojë pasurinë e saj, por gjithmonë brenda qëllimit të objektit të Shoqërisë. Shoqëria mund të shesë mallra ose të përfitojë të drejta materiale të tjera.

Neni 15

Shoqëria krijon fonde rezervë ose fonde të tjera të posaçme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike. Shoqëria ka mjetet e veta financiare. Shpenzimet e mundëshme që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë, mbulohen me fondet rezervë, ose me fonde të tjera apo edhe me kontribute shtesë që mund të bëjnë ortakët kur këto fonde ekzistuese nuk janë të mjaftueshme.

Kreu III

Administrimi

Neni 16

Organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë merren me vendim të Asamblesë së Ortakëve, e cila ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj.

Konkretisht Asambleja, ka kompetenca për të vendosur për çështjet e mëposhtme:

- a. ndryshimin e Statutit;
- b. rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- c. pranimin e ortakëve të rinj dhe transferimin e kuotave;
- d. ofrimin e udhëzimeve lidhur me punësimet dhe shkarkimet, shpërblimet, në veçanti për rolet menaxheriale;
- e. bashkimin, ndarjen, transferimin, riorganizimin, shpërbërjen dhe çdo transformim tjetër të Shoqërisë;
- f. blerjen, shitjen ose dhënien me qira të pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;
- g. emërimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve, të ekspertëve kontabël dhe të likuidatorit dhe përcakton shpërblimin e tyre;
- h. miratimin e raporteve vjetore;
- i. miratimin e bilancit;
- j. shpërndarjen e fitimeve;
- k. kërkon dhënien e kredieve, hipotekave dhe/ose dhënia e garancive;
- l. shitjen, shndërrimin, transferim patentash, licencash apo koncesionesh;
- m. për të gjitha çështjet e tjera të cilat nuk parashikohen shprehimisht në këtë Statut dhe që i takojnë ortakëve sipas Ligjit për shoqëritë tregtare.

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve merren në bazë të kërkesave të kuorumit dhe shumicës përkatëse të parashikuara nga Ligji për shoqëritë tregtare.



Neni 17

Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori/ët i Shoqërisë të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim, brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar dhe çdo herë tjetër kur e kërkon interesi i Shoqërisë dhe në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

Kur Asambleja e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të përshkruara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë, duke nënshkruar me shkrim vendimet përkatëse.

Neni 18

Administrimi i Shoqërisë i caktohet dy administratorëve, të cilët do të jenë secili përfaqësues ligjor të Shoqërisë.

Përveç rasteve të zëvendësimit, largimit ose shkarkimit, administratorët do të mbeten në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vitesh. Mandati është i rinovueshëm.

Administratorët mund të ushtrojnë individualisht të gjithë kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901 të 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratorët e Shoqërisë janë:

- i. **Z. Bledar Kulla**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, më 08.03.1982, me letërnjoftim me nr. personal I20308085R, për një mandat 3 (tre) vjeçar; dhe
- ii. **Z. Thierry Jean Pierre Di Garbo**, shtetas italian, lindur në Milano, më 26.05.1973, me letërnjoftim italian nr. AY5554901, për një mandat 3 (tre) vjeçar.

Neni 19

Administratorët ushtrojnë individualisht të drejtat e plota të caktuara për administrimin e Shoqërisë dhe kanë të drejtën të miratojnë vendimet që gjykojnë të drejta për arritjen dhe realizimin e objektivit të Shoqërisë dhe të nënshkruajnë kontratat e nevojshme, me përjashtimin e vetëm të veprimeve që me këtë statut apo me ligj i janë rezervuar ortakëve.

Veprimet e mëposhte përfshihen në aktet e administrimit të zakonshëm të cilat mund t'i kryejë secili prej administratorëve individualisht:

- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
- b. hapja e llogarive bankare të Shoqërisë pranë Institucioneve bankare;
- c. përfundimi i kontratave ose marrëveshjeve me palët e treta;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, veprimet bankare, transferimet, pagesën e detyrimeve të Shoqërisë;
- e. punësimi, shkarkimi, përcaktimi i pagave dhe shpërblimeve të tjera dhe çdo vendim tjetër lidhur me stafin e Shoqërisë, në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Ortakët;

- f. mbajtja e librave kontabël, siç parashikohet nga ligji dhe parimet e kontabilitetit;
- g. përgatitja e pasqyrave financiare të Shoqërisë dhe verifikimi i tyre nga auditorë të jashtëm, në rast se kërkohet me ligji ose nga Ortakët;
- h. çdo veprim tjetër që sipas Ligjit për Shoqëritë tregtare i takon administratorëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Administratorët, me prokurë të posaçme mund t'i delegojë palëve të treta përbushjen e akteve të vetme ose kategori të akteve.

Kreu IV

Viti financiar, pasqyrat financiare vjetore, ndarja e fitimit

Neni 20

Viti financiar fillon më datë 1 janar e përfundon më datë 31 dhjetor.

Përrjashtim bën viti i parë financiar që fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar dhe përfundon më 31 dhjetor të po të njëjtit vit.

Neni 21

Pasqyrat Financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe i ekspertit kontabël miratohen nga Asambleja e Ortakëve. Miratimi i dokumenteve përkatës për vitin financiar bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 22

Të ardhurat e fituara nga Shoqëria, duke hequr të gjithë detyrimet dhe fondet rezervë për rritjen ekonomike, investimet, reklamat etj, janë të destinuara për ortakët, në përputhje me ligjin e zbatueshëm. Ortakët kanë të drejtë të marrin një pjesë të fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë, i cili do të shpërndahet në raport me kuotat e zotëruara në shoqëri dhe në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja, kontrolli i bilancit dhe i librave kontabël të Shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël. Shkarkimi mund të ndodh në çdo moment në të njëjtën mënyrë si emërimi.

Kreu V

Prishja e Shoqërisë

Neni 24

Shoqëria prishet në rastet e parashikuara me ligj ose me vendim të Ortakëve në përputhje me ligjin për Shoqëritë Tregtare. Kur Shoqëria prishet ajo vendoset në likuidim.

Për ndjekjen e procedurës së likuidimit Asambleja e Ortakëve emëron një apo disa likuidatorë të cilët do të kryejnë procedurat përfundimtare në lidhje me aktivet dhe pasivet e Shoqërisë, procedurat e likuidimit në kohën e duhur e deri në përfundim të procedurës së likuidimit.

Në fund të procedurës së likuidimit, Asambleja e Ortakëve do të vendosë mbi bilancin përfundimtar, vlefshmërinë e punës së kryer nga likuidatori/ët dhe përfundimin e procedurës së likuidimit.

Pas shlyerjes së kreditorëve, likuidatori shpërndan të ardhurat përfundimtare të likuidimit tek ortakët, në proporcion më kuotat që zotërojnë.

Kreu VI

Dispozita të fundit

Neni 25

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin lidhur me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij Statuti apo ndërmjet organeve të Shoqërisë do të përpiqen të zgjidhen miqësisht me marrëveshje mes palëve.

Në rast se mosmarrëveshjet nuk do të zgjidhen miqësisht do t'i drejtohet Gjykatës kompetente të Tiranës.


Neni 26

Ky statut hartohet në 4 (*katër*) kopje në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 10.01.2018

ORTAKËT E SHOQËRISË

Z. Bledar Kulla



Z. Thierry Jean Pierre Di Garbo

